




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.31, datë 23.12.2024

PËR



**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SUBJEKTI “GJIKURIA” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik subjekti “Gjikuria” nëpërmjet hidrocentralit “Babun”, në ujërat e përroit të Mocalit të Ariut dhe të Sharrës, degë të lumit Grabovë, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan”..
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC Babun

Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujor Përroi Moçal

- X= 534075; Y= 4514536; Z=1153 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.6 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.37 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.046 m³/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 2/ burimi ujq Përroi Sharrës

X=533883; Y=4514183; Z=1153 m.m.n.d. (KRGJSH)

- Prurja llogaritëse: 0.3 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.27 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.034 m³/s

Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 532482; Y=4515904; Z=871 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 0.9 m³/s
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 8.068.174 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 2000 kwh
- Vlera totale e investimit: 234,875,582 lekë me TVSH.

Koordinatat e pikës së shkarkimit ku kanali i largimit të godinës së HEC-it, takon trupin ujq pritës:

- X=532457; Y=4515892; Z=868 m.m.n.d. (KRGJSH)

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit te subjektit te interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

ARBEN ÇUKO

